



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 12

Datë: 31. 03. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 11/2022:**
- 3. Aktivitetet e SKQZ:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC:**
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - Këshilli për Çështje Ligjore:**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të KQZ-së, për adresimin e rekomandimeve të Misionit të Vëzhgueseve të Zgjedhjeve-MVZ të BE-së, për zgjedhjet lokale 2021

-Shqyrtimi dhe miratimi i Analizë së Votave me Asistencë, për zgjedhjet lokale 2021

-Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për Modifikimin dhe Avancimin e Ueb faqes së KQZ-së

-Njoftim Raport - Dita Globale e Zgjedhjeve

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi i kërkesës për transferim të mjeteve nga programi i Sekretariatit në programin e zgjedhjeve

6.Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së, në vëzhgimin e zgjedhjeve në Slloveni

7. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KOZ-së: Sipas rendit të ditë, e fillojmë takimin. A ka dikush për të shtuar, ndonjë propozim me rendin e ditës ?

Ilir Gashi: Pika e gjashtë, ose duhet të riformulohet ose të hyjë ndonjë pikë tjetër si pikë e shtatë, dhe çështja e punëtorisë lidhur me rregullat zgjedhore, pra deri kur ka shkuar kjo çështje...!

Sami Kurteshi: Ne, kemi pranuar një letër nga z. Buzhala, a doni me e pas në rend të ditës...?

Kreshnik Radoniqi: Mendoj që, duhet mu lënë në takimin e radhës, se duhet me u pa...

Alim Rama: Ajo letër duhet mu qartësua, kurse te raporti i ditës globale të zgjedhjeve nuk e kemi trajtua në KOZ...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Miratohet rendi i ditës. Pastaj, në vazhdim miratohet edhe procesverbali nr. 11/2022.

2. Aktivitetet e SKQZ:

Burim Ahmetaj, krye shëf i Sekretariatit, tha se aktiviteti mbi planin e punës të KQZ-së për ndryshimin dhe plotësimin e rregullave zgjedhore po zhvillohet bazuar në takimet e shumta për realizimin e këtij aktiviteti. Grupi Punues, nga data 03.03.2021, e deri me datën 28.03.2022, ka trajtuar dhe përfunduar me sukses ndryshimet dhe plotësimet e 20 rregullave zgjedhore. Besojmë që më datën një prill, grupi punues do të takohet për finalizimin dhe rishikimin e bazës ligjore për të gjitha rregullat, si në vijim: 1.Rregulla Zgjedhore për Rezultatet Preliminare xx/2022, është draftuar nga Komision i veçantë për draftimin e kësaj rregulle dhe është shqyrtuar nga Grupi Punues për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullave Zgjedhore. Në këtë grup punues ka qenë i përfshirë edhe një përfaqësues nga OSBE-ja. Sekretariati i ka draftuar të gjitha ndryshimet dhe tashmë është i gatshëm të njoftojë paraprakisht Këshillin për Çështje Ligjore me të gjitha ndryshime-plotësimet e Rregullave Zgjedhore, para se të organizohet një punëtori e veçantë, e cila është planifikuar të përkrahet nga OSBE-ja.

Një aktivitet tjetër, tha z. Ahmetaj, lidhet me planin e punës së KQZ-së. Takimi ndërmjet ZLKZ-ve dhe Sekretariatit, është realizuar më 23 mars, gjë që kemi të bëjmë me takimin e parë nga katër takimet sa janë planifikuar gjatë vitit. Në këtë takim të përbashkët, e ku prezantonte edhe përfaqësuesi i OSBE-së, u trajtuan temat: Plani i punës së KQZ – 2022, Rekomandimet e Bashkimit Evropian – të gjeturat e vëzhguesve të BE-së, dhe Identifikimi i sfidave në proceset e kaluara zgjedhore. Punëtorja, ka shërbyer si një vend për të diskutuar për zbatimin e planit të punës dhe të aktiviteteve për vitin 2023. Përveç kësaj, ky takim, është dizajnuar për të adresuar rekomandimet e MVZ-së të BE-së si dhe komunikimin e Sekretariatit me Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve në secilën Komunë. Në kuadër të këtij aktiviteti janë paraparë edhe tri punëtori të tjera të cilat gjithashtu do të mbështeten nga OSBE-ja.

Gjithashtu, tha Ahmetaj së shpejti do të raportojë për zbatimin tre mujor të aktiviteteve të Planit të Punës së KQZ-së. Gjithashtu, ju njoftojmë se me kërkesën e USAID, më datën 25 mars, kryeshefi Ekzekutiv dhe drejtori i Departamentit të Teknologjisë Informative janë takuar me ekipin nga USAID në Uashington dhe Prishtinë lidhur me hulumtimin dhe analizën që USAID është duke bërë për mundësisë e Qeverisjes digjitale apo E-Qeverisjes në Kosove, si dhe të explorimit të mundësisë që USAID të kyqet në këtë fushë në të ardhmen e afërt. Në këtë takim janë prezantuar

aktivitetet e KQZ-së dhe synimet për digjitalizim dhe është prezantuar si nevojë përkrahja nga USAID në fushën e digjitalizimit të shërbimeve.

Në vazhdim, z. Ahmetaj e informoi KQZ-në se nga Ministria e Pushtetit Lokal më datën 21 mars 2022, ka ardhur një kërkesë për të caktuar një përfaqësues nga KQZ për “Grupin punës” për hartimin e koncept dokumentit për Ligjin Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës. Duke parë natyrën e kërkesës, përfaqësues nga ana e KQZ-së është z. Xhemail Peqani, Zv. Kryeshef i SKQZ-së.

Po ashtu, më 22 mars 2022 nga Sekretaria e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ka ardhur kërkesë për të caktuar një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për themelimin e “Ekipit punës” për hartimin e Draftit fillestar të Projekt Ligjit për Paga në sektorin Publik. Duke parë natyrën e kërkesës, përfaqësues nga ana e KQZ-së është z. Nexhmedin Hyseni, Drejtor i ZRPPC. Sekretariati ka përgatitur dhe dërguar pyetësonin vetë vlerësues për kontrollin e brendshëm dhe financat publike, i cili është obligim ligjor dhe plotësohet online nga Institucionet. Me datë 9 shkurt nga Ministria e Financave janë njoftuar te gjitha Subjektet e Sektorit Publik (SSP) për detyrimin sipas nenit 16 dhe 16 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm dhe Financat Publike (KBFP) për të plotësuar pyetësonin vetë-vlerësues (01-31.03.2022) për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Pyetësoni është plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave.

Diskutime dhe pyetje rreth raportit, shtruar **Alim Rama** i cili tha se rekomandimet e raportit lidhur me grupin punues për ligjin për zgjedhjet, atë për paga sikurse, edhe pyetësoni i vetëvlerësimit, është dashur të trajtohen së pari në këshillat përkatës...

Sami Kurteshi, rreth takimit të Sekretariatit me USAID-in tha se, duhet më shumë me u informua, kurse rreth koncept-dokumentit për ligjin për zgjedhjet, jo vetëm të informohemi por ti dërgojmë edhe ne rekomandimet...Pra, të takohemi, ta trajtojmë dhe ti japim rekomandimet tona...

Kurse, kur kërkohet një përfaqësues i KQZ, ne duhet të njoftohemi me kohë dhe ta shohim se kush po shkon, kush po kërkon, pse po shkon...

Ilir Gashi: Si për ligjin e zgjedhjeve lokale dhe si atë për pagat, unë mendoj se ne duhet ti dërgojmë emrat se kush duhet të na përfaqësoj, dhe ne duhet të shkojmë me dokumentin tonë, dhe jo me

vlerësime dhe qëndrime tona... Duhet ta kemi përfaqësimin dinjitoz, mendoj që kryetari duhet të na përfaqësojë...

Sami Hamiti, pyeti: Dy ministrinë, ajo e Pushtetit Lokal dhe MPB a kanë komunikuar me ju, sepse është nivel elementar i përfaqësimit... Unë, këtu e shoh gabimin ! Niveli i komunikimit, dhe ata janë gabim...Madje, edhe trajtimi është gabim, sepse së pari duhet të trajtohet ligji për zgjedhjet qendrore, e tek masandej ligji për zgjedhjet lokale...Kjo, është çështje serioz, dhe KQZ duhet të jetë pjesë e reformës... Çështjet tjera, edhe mund të përfaqësohen e trajtohen nga sekretariati, madje edhe të përfaqësohen...

Čemailj Kurtiši, pasi që falënderoi për raportin, tha se nuk mund të themi që s’kemi qenë të informuar por më shumë duhet të informohemi, dhe duket që gabimi është tek ministrinë... Legjitimiteti, është më i fuqishëm, nëse përfaqësimi shkon përmes KQZ-së dhe kjo është në interes të përbashkët...

Alim Rama, tha se “nuk kam asgjë kundër emrave” por, komunikimi dhe trajtimi të shkojnë njëherë përmes këshillave, e pastaj te KQZ...

Kreshnik Radoniqi: Mendoj se, ata kanë kërkuar nga Sekretariati përfaqësim për shkak të relacionit, sekretariat me sekretariat..

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Sami Kurteshi dhe Ibrahim Selmanaj.

3.Aktivitetet e ZRPPC

Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP: Sipas raportit, ne dje ju kemi informuar se në ligjit dhe rregullores së punës, secila parti politike e regjistruar duhet të lajmëroj vazhdimin e regjistrimit kalendarik çdo vit, jo më larg se 31 marsi...! Kjo, bëhet sipas procedurave me dorëzimin e formularit të regjistrimit të partisë politike. Kështu, nga 51 parti politike nga Regjistri i partive, vetëm 2 parti politike nuk kanë qenë të obliguara, sepse ato sapo janë regjistruar si parti, kurse partitë e tjera kanë dorëzuar formularët...

Gjithashtu, tha z. Hyseni, Zyra ka vëzhguar dy kuvende të partive politike: më 26 mars, zyra ka përcjellë kuvendin e partisë politike “Alternativa” në Gjakovë, dhe zyra e disponon raportin nga

ky kuvend. Dhe, më 27 mars, kemi përcjellë edhe kuvendin e parë të partisë politike të regjistruar këtë vit, atë të partisë “Bashkimi për ndryshim Anamorava” në Gjilan, dhe ne kemi edhe raportin.

Zyra, ka vazhduar edhe me aktivitete të tjera...

Sami Kurteshi: Në lidhje me raportimin e ZRPPC unë kam ngritur dy çështje, të cilat tani nuk mund t’i citoj saktësisht edhe pse i kam ngritur vetë, por po përpiqem ta përforcoj përafërsisht.

E para, unë kam pyetur nëse shifra e dhënë në paragrafin e 7 të Raportit të ZRPPC për vlerësimin e NIS tregon mesataren e vlerësimit për të gjitha institucionet e vlerësuara, apo vlen vetëm për KQZ e Kosovës. Përgjigja ishte kjo vlen vetëm për KQZ.

E dyta, unë kisha një vërejtje dhe rekomandim në lidhje me paragrafin 5 të Raportit të ZRPPC. Vërejtja dhe rekomandimi im ishte që kuvendin e partisë politike Alternative e ka përcjellur me autorizim të ZRPPC zyrtari i lartë komunal të zgjedhjeve (ZLKZ). Ky është veprim i kundërligjshëm dhe nuk është i lejueshëm. Kuvendet qendrore të partive politike në emër të KQZ i përcjell vetëm një zyrtar i ZRPPC por jo ZLKZ. Me sa më kujtohet, me të njëjtin rekomandim dhe vërejtje ishin edhe diskutimet e anëtarëve të tjerë të KQZ në lidhje me këtë çështje.

Mbas prezantimit të raportit, në këtë pikë diskutuan dhe shtruan pyetje Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama, Ilir Gashi. Në pyetjet e shtruara dha përgjigje z. Hyseni.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

1. Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë:

Sami Hamiti: Sot jemi takuar në këshill, dhe kemi shqyrtuar një zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë. Sipas dokumentacionit, janë përmbushur kushtet ligjore dhe ne rekomandojmë për votim nga KQZ.

Kreshnik Radoniqi: I dorëhequri në kuvendin e komunës së Prishtinës, z. Fadil Aliu zëvendësohet nga Driton Rukiqi, nga subjekti politik LDK.

Miratohet me 11 vota miratohet ky zëvendësim.

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të KOZ-së, për adresimin e rekomandimeve të Misionit të Vëzhgueseve të Zgjedhjeve-MVZ të BE-së, për zgjedhjet lokale 2021:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar këtë plan të veprimit për adresimin e rekomandimeve të Misionit të Vëzhgueseve të Zgjedhjeve-MVZ të BE-së, për zgjedhjet lokale 2021. Janë të listuara 12 rekomandime, dhe disa janë edhe nga herët e kaluara nga zgjedhjet e kaluara lokale. Disa nga rekomandimet, ne e dimë që kërkojnë edhe ndryshimin e ligjit për zgjedhjet, por edhe të ligjit të financimit të partive politike. Mirëpo, janë disa rekomandime që ne mund ti ndryshojmë të rregullat zgjedhore, dhe ne mund të ndërmarrim hapat tonë. Në plan të veprimit, në raportet e të gjeturave dhe në aktivitetet e tjera, trajnimet dhe aspektet e tjera etj., ne kemi të listuara çështjet dhe rekomandimet se si të veprohet dhe ne sugjerojmë miratimin...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e këtyre adresimeve ?

Me 10 vota për miratohet

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së Votave me Asistencë, për zgjedhjet lokale 2021”

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar edhe “Analizën e Votave me Asistencë” të përgatitur nga Sekretariati. Është një analizë që ngërthen të gjitha kërkesat tona, domethënë të KOZ-it ku ne kemi kërkuar që të përfshihen sa më shumë të dhëna në mënyrë statistikore...! Një gjë që vlen të theksohet, është se kemi numër më të ulët të votimit me asistencë, dhe kjo është meritë e përbashkët. Pra, nëse e krahasojmë me vitin 2017, kemi 12 602 votues më pak me asistencë, ndërsa në vitin 2019 kemi 12 300 votues më pak. Ajo që vihet në pah, 69 % kjo mënyrë e votimit me asistencë është përdorur në zonat rurale, krahasuar me zonat urbane...Ky, asistimi, lidhet kryesisht me gratë, pra me gjininë femërore dhe, shkaset duhet të studiohen se cilët janë ata...

Elshani, analizoi dhe elementë të tjera, ndërsa që kërkoi që kjo analizë të miratohet.

Sami Hamiti, tha se konstatimi i të gjithëve ishte se, kemi përpara një analizë të mirë dhe, unë e përgëzoj grupin që ka punue. Hamiti, tha se, ky trend, duhet të shkoj kah zvogëlimi dhe se, qartësitë në analizë japin referenca që duhet shfrytëzuar...

Sami Kurteshi, tha se njëmend është një analizë e mirë, dhe ajo që më ka bërë përshtypje janë disa mostra që nuk janë të qarta dhe dëshmojnë për shkelje të qarta të së drejtës së asistimit dhe keqpërdorim të kësaj të drejte. Prandaj këto shkelje duhet të hiqen...sepse, mund të keqpërdoren dhe janë të rrezikshme...Pra, disa mostra nuk duhet lejuar...Mendoj që, disa përqindje nuk janë mirë, dhe të llogariten përsëri...Pastaj, kemi persona që asistojnë më shumë se dy herë...dhe kjo, duhet të shmanget... Po ashtu, kërkesë e imja është që të dërgohen për hetim në institucionet kompetente të gjitha rastet ku i njëjti person ka asistuar më shumë se një herë, qoftë në të njëjtin VV apo edhe në VV të ndryshme. Sigurisht ka raste kur një person ka asistuar 2 herë për prindërit e tij të moshuar që vërtetë kanë nevojë për ndihmë, por rastet e tjera janë të dyshimta për keqpërdorime.

Alim Rama, tha se të gjeturat janë goxha të frikshme sepse mbi 43 602 kanë kërkuar asistencë që i bie 5.42% e votave të përgjithshme... Dhe, 73% e tyre, janë gra dhe mendoj që duhet të shmanget asistenca më shumë se dy herë...

Rifat Krasniq, tha se duhet të shohim pse po dalin vota të pavlefshme, se sa të pengohet asistenca sepse, ka njerëz që duan asistencë se ka shumë votues analfabet... Ata, me kënd votojnë, me njerëzit e afërt të tyre...

Kreshnik Radoniqi: Nuk po e mohojmë asistencën, por me pas më shumë kontrollë që të mos keqpërdoret asistenca...

Në këtë pikë, diskutuan më tej Qemal Kurteshi, Sami Kurteshi dhe Fazli Stollaj.

Në fund, ky rekomandim me 10 vota për, miratohet.

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për Modifikimin dhe Avancimin e Ueb faqes së KOZ-së:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar edhe projektin për Modifikimin dhe Avancimin e Ueb faqes së KOZ-së, dhe këto janë çështje teknike që do të kenë parasysh dizajnimin dhe rregullimin e ueb faqes që, të gjithë të kemi qasje më të mirë. Po ashtu, është kërkuar që të rritet transparenca

në ueb faqe, dhe ka ritme dhe përditësime të dokumenteve...Pra, konsiderojmë që të aprovet ky projekt...

Miratohet.

Njoftim Raport - Dita Globale e Zgjedhjeve:

Arianit Elshani, në fund e njoftoi KQZ-në edhe lidhur me këtë pikë, si për rëndësinë e po ashtu, edhe për fillimin e zbatimit të projektit ku ne kemi aprovuar idenë që KKZ-të të mbajnë ligjërata lidhur me zgjedhjet, rëndësinë dhe rolin e tyre etj. Tash, masat kovid nuk e pengojnë këtë aktivitet...

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi i kërkesës për transferim të mjeteve nga programi i Sekretariatit në programin e zgjedhjeve:

Gordana Llaban: Në takim të këshillit, kemi shqyrtuar kërkesën për transferim të mjeteve nga programi i Sekretariatit në programin e zgjedhjeve. Këshilli, ka vlerësuar se 49 660, 93 euro të zhvendosen nga një program të sekretariatit, dhe të vendosen në programin e zgjedhjeve. Disa njerëz nuk janë paguar, dhe për të mos e përsëritur çështjen ne kemi konstatuar se, ata duhet të paguhen...

Rekomandojmë për aprovim..

Miratohet

6.Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KOZ-së, në vëzhgimin e zgjedhjeve në Slloveni

Kreshnik Radoniqi: Këtu, realisht kemi dy pika, një për pjesëmarrje në Slloveni dhe një për Rregullat Zgjedhore.

Propozimi, është që unë, Sami kurteshi, Arnianit Elshani, Rifat Krasniq dhe dikush nga Sekretariati t'i vëzhgojmë zgjedhjet në Slloveni.

Miratohet ekipi

Burim Ahmetaj: Kurse, sa i përket rregullave zgjedhore për punëtorinë, çështja është se data e caktimit të mbajtjes së saj, do të duhej të ishte 18 prilli, ose 26 prilli. Pra, në bashkëpunim me OSBE-në...KQZ, ta miratoj datën...

Kreshnik Radoniqi: A kemi pajtueshmëri që prej 17 - 21 prill 2022 të mbahet kjo punëtori.

Parimisht, u vendos që ky interval kohe të merret për bazë...

Miratohet

6. Të ndryshme !

Për KQZ

Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi
